

BASHKIA LUSHNJE
NJOFTIM ANKANDI

1. Autoriteti shitës: Bashkia Lushnje

Adresa: Lagjia :” Kongresi i Lushnjes “ Lushnje
Tel/Fax: + 355 35 221 39
E-mail: bashkia_lushnje@yahoo.com
Adresa e Internetit: www.bashkialushnje.gov.al

2. Data e zhvillimit të ankandit: 01/04/2025 ora: 10.00

3. Lloji i Procedurës standarde te ankandit: Proçedurë e hapur

4. Objekti i Shitjes: “Shitje me ankand të aksioneve të Klubit të Futbollit Lushnja 1930 sh.a, në masën 100%”.

5. Përshkrim i shkurtër i objektit te shitjes:

KLUBI I FUTBOLLIT LUSHNJA 1930 sh.a është krijuar më 06.09.2013 me Vendim Nr.60 të Këshillit të Bashkisë Lushnje, si një shoqëri aksionare me ofertë private. KLUBI I FUTBOLLIT LUSHNJA 1930 sh.a ka selinë në Lagjia “Xh.Nepravishta” në stadiumin Roza Haxhiu, Lushnje.

Futbolli ka një histori suksesi 94-vjeçare për Qytetin e Lushnjes. Klubi Futbollit Lushnja (KF Lushnja) u themelua më 27 korrik 1930 në Lushnje. Aksionet zotërohen 100% nga Bashkia Lushnje

Objekti i aktivitetit të Shoqërisë KLUBI I FUTBOLLIT LUSHNJA 1930 sh.a është: Organizimi i aktiviteteve sportive të futbollit; krijimi i ekipeve zinxhir dhe pjesëmarrja në garat sportive të organizuara nga Federata Shqiptare e Futbollit; aderimi dhe regjistrimi si klub në Federatën Shqiptare të Futbollit dhe në të gjitha llojet e aktiviteteve të futbollit kombëtare dhe ndërkombëtare; Futja në

tregun e lojtarëve për të blerë lojtarë sipas nevojave të ekipit; aktivitete të tjera në fushën e futbollit për interesat e shoqërisë; Shoqëria, brenda kufijve të parashikuara nga legjislacioni në fuqi, do të kryejë çdo operacion tregtar dhe financiar që lidhet drejtpërdrejtë ose tërthorazi me objektin e saj.

6. Vlera fillestare: 14,077,066 (katërmëdhjetë milion e shtatëdhjetë e shtatë mijë e gjashtëdhjetë e gjashtë) lekë

7. Vendi i zhvillimit të ankandit: (Adresa:) Salla e mbledhjeve kati 2, Bashkia Lushnje.

8. Afati i fundit kohor për dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje:

01/04/2025 ora: 10.00

9. Informacion mbi dokumentet e ankandit:

Dokumentet e ankandit mund të trerhiqen prane autoritetit shitës

Dokumente me pagesë:

Po ☐ Jo ☒

Dokumentet standarde të ankandit përbëhen nga:

- Formulari i njoftimit;
- Kërkesa për pjesëmarrje;
- Formulari i ofertës;
- Ftesa për ofertë;
- Formulari i njoftimit të fituesit;
- Formulari i publikimit të njoftimit të fituesit;
- Procesverbali/et i/e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave.

10. Kërkesa për pjesëmarrje, dokumentet dhe informacionet e kërkuara dorëzohen nga kandidatet blerës në kopje fizike, me poste ose dorazi, në vendin e përcaktuar në dokumentet e ankandit .